



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

MARRËVESHJA PUBLIKE KORNIZË

MARRËVESHJA PUBLIKE KORNIZË

Agjencia Qendrore e Prokurimit (më tej i quajtur "Autoriteti Kontraktues "), në njëren anë;
dhe

Operatorët Ekonomik të paraqitur në tabelën në Nenin 6.1 të marrëveshjes (më tej i quajtur "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar si në vijim:

Për të përmbyllur një kontratë publike kornizë për Furnizim : Marrëveshje kornize - Furnizim me Pemë dhe Perime me numër të identifikimit: UA/2016-19-9623-1-1-1

Neni 1

Lënda

- 1.1 Lënda e kësaj Marrëveshje publike kornizë është për tu pajtuar mbi rregullat për krijimin e kontratave ndihmese të cilat do të kryhen përmes procesit të mini-konkurrencës vetëm në mes të operatorëve ekonomik që janë palë e kontratës publike kornizë.
- 1.2 Kjo Marrëveshje publike kornizë në vetvete nuk është një kontratë, por përcakton termat dhe kushtet për kontrata ndihmëse, Specifikat teknike në Aneksin 1 që janë pjese e kësaj kontrate janë vetëm specifika minimale ndërsa gjatë implementimit të kontratës gjatë përdorimit të mini tenderëve AK-se do të përdorin specifikat teknike të Aneksit 1 ose do të hartojnë specifikat teknike më të avancuara sipas nevojave dhe kërkesave.
- 1.3 Furnizuesi është vetëm njëra nga palët e Marrëveshje publike kornizë.
- 1.4 Palët tjera të Marrëveshje publike kornizë janë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate.

Neni 2

Obligimet

- 2.1 Autoriteti kontraktues, me këtë rast, konfirmon se do t'i lëshojë Furnizuesit "Ftesë për Kuotim" (FPK) sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim.
- 2.2 Furnizuesi, nga ana tjetër, pajtohet që të bëhet njëra nga palët e Marrëveshje publike kornizë dhe të paraqesë një ofertë sa herë që kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese që përdorin këtë marrëveshje.

Neni 3

Kontratat Ndihmëse

- 3.1 Kontratat ndihmëse do të jepen vetëm nëpërmjet një procesi të mini-konkurrencës.

Neni 4

Procesi i Mini-konkurrencës

- 4.1 Procesi i mini-konkurrencës do të kryhet në mes të të gjitha palëve të Marrëveshje publike kornizë sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim për Autoritetet Kontraktuese që përdorin këtë marrëveshje.
- 4.2 Autoriteti Kontraktues do të ri-hap konkurrencën në bazë të kushteve të njëjta ose të formuluar më saktësisht, nëse është e nevojshme, të definuara në Pjesën A të Dosjes së Tenderit.
- 4.3 Sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim , Autoriteti kontraktues përgatit Ftesën për Kuotim (FPK) dhe do të lëshojë FPK për të gjitha palët e Marrëveshje publike kornizë. Vlerësimi i kontratës ndihmëse do të bazohet në kriteret e theksuara në FPK.
- 4.4 Çdo kontratë ndihmëse do të jete subjekt i publikimit të Njoftim për Dhënie e Kontratës, ti nënshtrohet kërkesave për nënshkrimin e kontratës dhe rregullave të paraqitjes së ankesave në përputhje me LPP.

Neni 5

Termet dhe Kushtet

- 5.1 Termet dhe kushtet për kontratat ndihmëse përcaktohen në Pjesën B të Dosjes së tenderit, Seksioni I, II, dhe III.

Neni 6

Palët e Marrëveshje publike kornizë

- 6.1 Palët e marrëveshjes kornizë publike janë si më poshtë:

Nr.	Emri i Operatoreve Ekonomik
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Korabi - Company Sh.p.k.; T & A COMPANY SH.P.K. rruga e Tiranës pn, VUSHTRRI
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. SKAND - IN; DONI PRODUCT SH.P.K. Lidhja e Lezhës, Nr.4, PRISHTINË
3.	" EXIM " SH.P.K. RR.ISMAIL QEMAILI, PRISHTINE
4.	Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjelbërt, PRISHTINË
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik BRAHIM ZEQIRI B.I.; ADA GROUP SH.A. Hajdar Dushi 14, PRISHTINË
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik ENZO SH.P.K.; N.T.P HAJDINI COMERC Rr. Ilaz Kodra - Drenas, DRENAS
7.	Grup i Operatorëve Ekonomik: " Onix1 " SH.P.K.; " Adriatiku " Sh.p.k. Tregu i Gjelebert, Prishtine
8.	N.P.T." Fatosi - Com " Rr.Ismaj Qemajli, Prishtine
9.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Florenti; AS-1 GROUP SH.P.K. Sheshi Mehë Uka, MITROVICË
10.	" RINESA 1 " SH.P.K. Ismajl Qemajli nr 35, Prishtine

Neni 7

Kohëzgjatja e Marrëveshje publike kornizë

7.1 Zbatimi i kësaj Marrëveshje publike kornizë do të fillojë me datën 01.09.2020 dhe do të përfundojë me datën 31.08.2023. Agjencia Qendrore e Prokurimit ka nënshkruar marrëveshjet me 10 Operatoret Ekonomik të lartpërmendur në Nenin 6.1.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Mursel Rraci



31.08.2020